



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. 24 Prot.

Tiranë më 15 / 1 /2015

Proces-verbal

Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së

Sot, në datën 15.1.2015 në orën 12.00, në ambientet e përkohshme të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërise Civile (AMSHC) u mbajt mbledhja e radhës e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së. Rendi i ditës sipas njoftimit paraprak të Kryetarit të Bordit parashkonte:

1. Diskutim rreth mekanizmave të bashkëfinancimit dhe donatorëve prioritarë për AMSHC-në në përbushjen e misionit të saj dhe arritjes së objektivave.
2. Diskutim rreth prioriteteve të Thirrjes për vitin 2015, duke konsideruar prioritetet e parashikuara me ligj dhe Vendimin e Bordit për të destinuar të paktën 20 % të buxhetit për bashkëfinancim të projekteve të finançuara nga donator të rëndësishëm (BE, USAID etj). Pas diskutimit, miratimi I thirrjes 2015 dhc publikimi i saj.
3. Kryetari i Bordit propozon nismën për një vlerësim analistik, teorik dhe në zbatim të ligjit të AMSHC-së, ngritjen e një grupei pune që do propozojë ndryshimet eventuale që duhen bërë për të garantuar kryerjen e misionit dhe qëllimit për të cilin AMSHC është konstituuar si propozim dhe interes të prezantuar edhe nga disa organizata të shoqërisë civile.
4. Të tjera

Verifikohet prania e Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së z. Andi Kananaj, si edhe anëtarëve si më poshtë:

1. Z. Adrian THANO
2. Z. Ismail ADEMI
3. Z. Alban DUDUSHI
4. Znj. Kozara KATI
5. Z. Gelardina Prodani

Kryetari i BM, Z. Thano, deklaron te hapur mbledhjen rreth orës 12:00 të mesditës.

Ai propozon lidhur me pikën 1 të rendit të ditës organizimin e një procesi konsultativ me OJF- të para shpalljes së Thirrjes dhe vetëm pas këtij procesi, miratimin e thirrjes 2015 dhc publikimin e saj.

Në fjalën e tij hyrëse ai vijon duke u shprehur:

Z. *Adrian Thano*: "Duke pasuar parasysh rendin e ditës për këtë mbledhje si edhe në lidhje me shpalljen e Thirrjes së radhës unë sugjeroj që të përcaktojmë një afat kohor prej afersisht 10 (dhjetë) ditësh me qëllim konsultimin rrëth prioriteteve të Thirrjes së ardhshme. Për mënyrën se si do të realizohet ky process konsultimi, për formën dhe vendine takimit por jo vetëm mund të diskutojmë dhe të jepim sugjerime së bashku."

Znj. *Kozara Kati* : "Sugjeroj që së pari të bëhet një listim i prioriteteve të qeverisë."

Znj. *Gelardina Prodani*: "Jam dakord me listimin e prioriteteve qeveritare dhe mendoj se duhen listuar fushat prioritare ku mendohet se ka nevojë pë ide dhe konsultim dhe këto fusha mund të lihen si një dritare e hapur për marje mendimi."

Z. *Andi Kananaj*, Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së u shpreh: "Jam dakord me sa u tha më sipç. Gjithashtu doja të raportoja se pritet të kemi një bashkëpunim të fryshtëm mes TACSO ( Technical Assistance for Civil Society Organisations), program i BE-së dhe AMSHC-së. Jemi gjithashtu në përfundim të dokumentit RoadMap dhe si fazë përmbyllëse pritet që eksperti kroat të ofrojë asistencën e tij të vyer për AMSHC-në"

Znj. *Gelardina Prodani*: "Ku konsiston RoadMap konkretisht?"

Z. *Andi Kananaj* u përgjigj: "RoadMap është një dokument i cili do të përafrojë politikat e qeverisë shqiptare drejt një ambient më mundësues dhe të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile. Është një përbledhje e fushave prioritare dhe propozim për një plan veprimi si edhe një strategji afatshkurtë, afatmësme, por edhe afatgjatë. Jemi duke bashkëpunuar ngushtë me Grupin e Larte Teknik të Punës dhe mbasi të kemi përfituar rezultatet përmbyllëse do të mirepresim eksperizën kroate. Ky dokument i rëndësishëm për shoqërinë civile do të sigurojë më shumë fonde për AMSHC-në në të radhmen."

Z. *Ismail Ademi* shtoi: "Përsa i përket strategjisë për integrim në kapitullin për shoqërinë civile shkruhet që AMSHC dhe Ministria e Integrimit European duhet të punojnë për të harmonizuar legjislacionin përkatës dhe në këtë pikë janë dhënë edhe këshilla për RoadMap. Përsa i përket sugjerimit për një process konsultimi lidhur me prioritetet shpre dakordësinë time me lënien e një afati kohor dhe sugjeroj që të kemi një adresë online ku të dërgohen propozime, mendime lidhur me prioritetet."

Z. *Andi Kananaj* u shpreh në vijimësi: "Po jam dakord që të ketë një process konsultativ me shoqërinë civile dhe më pas, bazuar në feedback-un e marrë nga ky process, të lëmë një takim për të diskutuar dhe miratuar prioritetet. AMSHC ka bërë një vlerësim paraprak të OJF-ve dhe bazuar në këtë vlerësim sugjrojmë që të ketë Thirrje të ndara veçmas sipas fushave dhe temtikave."

Z. *Adrian Thano* pyeti: "Atëherë a mendoni se dhjetë ditë janë të mjaftueshme për këtë process?"

Znj. *Kozara Kati* u shpreh: "Sugjeroj që të lëmë rrëth dy janë."

Z. *Andi Kananaj*: "Gjatë kësaj kohe do të mbledhim , sugjerimie, propozime rrëth prioriteteve dhe pastaj do t'ua paraqesim juve".

*Znj. Kozara Kati:* "Ne sigurisht do tē vlerësojmë ato prioritete tē cilat nē radhë tē parë i parashikon vetë ligji."

*Z. Adrian Thano:* "Sugjeroj që tē lajmërojmë OJF-të dhë tē presim propozime. Tē zhvillojmë një takim final konsultativ me pjesëmarrje të gjerë. Bordi ka bërë përpjekje për tritjen e transparencës me një institucion që dikur as që njihej masivisht. Mendoj se duhet tē vijojmë nē këtë rrugë."

*Znj. Kozara Kati:* "Dhe çdo informacion, e dhënë ose njoftim tē publikohet edhe online."

*Z. Adrian Thano:* "Atëherë sugjeroj që nga dita e sotme datë 15.1.2015 tē shpallim tē hapur procesin e konsultimeve dhë deri në datë 30.1.2015. Data 26.1.2015 tē përcaktohet si datë kur do tē zhvillohet takimi konsultativ me OJF-të dhë rreth një javë më vonë, në datë 2.2.2015 tē zhvillojmë mbledhjen e radhës me Bordin Ekzekutiv të AMSHC-së ku do tē paraqiten dhe do tē diskutohen tē dhënët dhe feedback-u i dalë nga procesi në fjalë si edhe tē shpallim thirrjen."

Të gjithë anëtarët e tjërë nē këtë mbledhjë shprehën miratimin e tyre për sugjerimin e Kryetarit të Bordit të AMSHC-së.

Më pas nē vijimësi tē mbledhjes Kryetarit të Bordit të AMSHC-së, z. Adrian Thano vazhdoi me një propozim. Ai u shpreh: "Unë dhe znj. Kozara kemi një propozim që ka tē bëjë me ngritjen e një grupei pune për tē zgjidhur përplasjet që ka ligji aktual i AMSHC-së me ligjin për nëpunësin civil."

*Znj. Gelardina Prodani* tha: "Ka një interpretim tē ligjit nē këtë rast."

*Znj. Kozara Kati* u shpreh: "Sugjeroj që ligjit për AMSHC-në t'i bëjmë një vlerësim nē aspektin e kryerjes së misionit dhe qëllimit tē AMSHC-së. Ky vlerësim mund tē jetë nē formën e një konsult tē brendshmë dhe tē realizohet nga një grup i brendshëm pune i AMSHC-së, por mund tē ketë edhe përfaqësues tē jashtëm si për shembull dy ekspertë ligjorë."

*Z. Ismail Ademi* vazhdoi: "Unë sugjeroj që tē presim përfundimin e RoadMap dhë më pas tē ngrejmë grupin e punës tē cilin ju sugjeroni, dhe ky grup punc mund tē jetë edhe një grup i muksuar si me ekspertë tē brendshëm edhe tē jashtëm gjithashtu."

Anëtarët e tjërë tē pranishëm nē këtë mbledhje shprehën dakordësinë e tyre lidhur me sugjrimet e mësipërmre.

Pas kësaj, Kryctari i Bordit thotë se dëshiron që anëtarët tē dëgjojnë dhe më pas tē diskutojnë një prezantim tē Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së lidhur me dy propozime mbi mundësinë e bashkëfinancimit tē fondit prej 20%.

*Z. Andi Kananaj*, Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së raportoi për çështjen nē fjalë duke thënë : "Lidhur me 20% i cili përbën shumën e fondit tē lënë për bashkëfinancim,kemi pasur dy propozime. Propozimi i parë lidhet me mundësinë e bashkëpunimit me REK –un për tē bashkëfinancuar një projekt për ambientin, ndërsa propozimi i dytë lidhet me mundësinë e bashkëpunimit me një projekt tē qeverisë sllovene që ka tē bëjë me një projekt për ambientin nē qytetin e Korçës."

*Z. Isamil Ademi* u shpreh: "Duke vlerësuar rëndësinë e bashkë-financimit dhë duke i mëshuar faktit që është prioritarc që 20%-shi t'i dedikohet projekteve me bashkë-financim, unë mendoj së është shumë e rëndësishme gjithashtu që tē përqëndrohcmi te mundësitë e bashkëpunimit me donatorët e

mëdhenj (si pér shembull Bashkimi Evropian, USAID, UNDP etj.) që janë parësorë në të gjitha nivelet e bashkëpunimit si qeveritarë ashtu edhe privat."

Znj. *Kozara Kati* vazhdoi: "Në rastet e bashkëpunimeve dhe bashkë-financimit me donator të mëdhenj si edhe me projekte të financaura nga BE, vizibiliteti bëhet më i dukshëm dhe partncriteti fiton më shumë kredite."

Z. *Ismail Ademi* tha: "Lidhur me këtë çështje ju kujtoj se AMSHC nuk është e detyruar që të akordojë gjithë shumën e fondit prej 20% të caktuar pér bashkëfinancim. AMSHC mund të zgjedhë që të ndajë këtë fond në dy ose më shumë pjesë në varësi të projekteve që do të propozohen pér bashkë-financim dhe mund të japë një pjesë të këtij fondi."

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, z. *Andi Kananaj* pyeti: "Si do të veprojë AMSHC-ja në rast se ngelet një shumë lekësh nga ky fond?"

Z. *Ismail Ademi* u përgjigj: "Sugjeroj që të bëjmë një vlerësim më të qartë duke e lenë si mundësi pasi mund të kemi edhe ndonjë projekt të mëvonshëm."

Z. *Adrian Thano*, kretari i Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së pyeti: "Si mendoni ta zhvillojmë procesin e aplikimeve pér këtë rast?"

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së u përgjigji: "Si tregull bëhet shpallje pér Thirrje pér të gjitha organizatat që kanë përfituar nga fondet e BE-së dhe ato mund të aplikojnë pér 20% të bashkë-financimit. Pas përzgjedhjes që do të bëhet nga AMSHC, do t'i kalohen propozimet pér miratim Bordit Mbikqyrës. Në këtë rast propozoj miratimin nga ana juaj që rekrutimi i stafit të realizohet sipas nevojës nga Titullari, sipas legjislacionit."

Në vijimësi Kryetari i Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së bëri edhe njëherë më dije çështjet kryesore të trajtuarë në këtë mbledhje të cilat ishin:

1. Përcaktimi i një afati kohor pér të realizuar një process konsultativ me OJF-të me qëllim marrjen e feedback-ut lidhur me fushat prioritare të Thirrjes së radhës të cilat duhet të jenë konform prioriteteve qeveritare.
2. Ky afat kohor do të jetë i hapur nga data 15.1.2015 deri në datë 30.1.2015.
3. Në datë 26.1.2015 (pothuajse në përfundim të procesit) do të zhvillohet takimi i madh konsultativ me OJF-të.
4. Në datë 2.2.2015 do të zhvillohet takimi i radhës me Bordin Mbikqyrës të AMSHC ku do të paraqiten rezultatet dhe të dhënat e nxjerra nga ky process si edhe do të miratohen prioritetet e Thirrjes së radhës.
5. Ngrijja e nje grapi pune i përbërë nga punonjësit e stafit të AMSHC-së i cili do te jetë përgjegjës pér mbarëvajtjen e procesit konsultativ.
6. Autorizimi i Drejtorit Ekzekutiv pér rekrutim të stafit

Mbledhja u mbyll rrëth orës 14:30.

Anëtarët e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së të pranishëm në këtë mbledhje, ranë dakord pér pikat e diskutuara dhe firmosën në përfundim të mbledhjes.

TIRANE



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile

Bordi Mbikqyrës i AMSHC-së

**Adrian Thano**  
Kryetar i Bordit Mbikqyrës

**Majlinda Dhuka**  
Nënkyetare e Bordit Mbikqyrës

**Albana Koçiu**  
Anëtar

**Aldo Merkoçi**  
Anëtar

**Endri Fuga**  
Anëtar

**Gelardina Prodani**  
Anëtare

**Ismail Ademi**  
Anëtar

**Kozara Kati**  
Anëtare

Dt 15 / 1 / 2015

